

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.43/2015, “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE” TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar të cilat iniciohem me qëllim realizimin e rekomandimeve të dhëna nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Këto rekomandime janë reflektuar edhe në Vendimin e Entit Rregullator të Energjisë, nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.” në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9 pika 6, Direktivës 2009/72/KE mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.

Qëllimi i këtij projektligji është rishikimi i disa dispozitave të ligjit aktual të cilat janë konsideruar nga Komuniteti i Energjisë si pengesa në realizimin e plotë të autonomisë së OST-së dhe ndarjes së OSHEE-së, si dhe përfrimin e plotë të ligjit me nenin 26, paragrafi 2, pika (c) dhe (d) të Direktivës 2009/72/KE, dhe me *Acquis Communautaire* në fushën e energjisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektakti nuk është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT, LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar është përafuar në mënyrë të konsiderueshme (të plotë) me Direktivën 2009/72/KE, të Parlamentit dhe Këshillit European, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike”, përfshirë kërkesat e parashikuara për çertifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit;

Në përfundim të procesit të çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Enti Rregullator i Energjisë, me Vendimin nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.” në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9 pika 6 të Direktivës 2009/72/KE mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ka vendosur çertifikimin e OST sh.a., me disa kushte.

Njëri prej këtyre kushteve përcakton se:

2. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të parashikimeve të nenit 8, pika 2, gërmat “c”, “f” dhe “l”, dhe “p”, të ”Rregullores për çertifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për energjinë elektrike”, OST sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregon garancinë në lidhje me:

- Bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimi, OST sh.a. do t’i paraqesë ERE-s prova dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme të lidhura me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksioneri i OST sh.a., Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kanë ndodhur janë efektive.

Shqipëria ka ratifikuar Traktatin e Krijimit të Komunitetit të Energjisë dhe është palë kontraktuese e detyruar të ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky Traktat, për këtë arsye është e tepër e rëndësishme marrja e masave për rregullimet e nevojshme në aktet ligjore dhe

nënligjore që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike në përputhje me Direktivën 72/2009 të Parlamentit Europian.

Duke marrë në konsideratë faktin se qëllimi kryesor i procesit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë është përgatitja e sektorit të energjisë të këtij rajoni për t'u integruar në tregun energjetik të BE-s nëpërmjet adoptimit dhe zbatimit të Acquis Communautaire në fushën e energjisë, ERE në vendimin e saj gjykon të nevojshme ndërhyrjet në Legjislacionin për Sektorin e Energjisë Elektrike, duke mbajtur parasysh detyrat e lëna në Opinionin 1/17 të datës 23 Janar 2017 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për çertifikimin e OST-së, (të cilës i referohet ERE në vendimin e saj), në të cilin thuhet se:

“Të vendosë kërkesa të tjera për kompaninë OST (brenda një afati kohor jo më tepër se 12 muaj) që kanë të bëjnë me:

- të ofrojë të dhëna që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk mund të propozojë miratimin (ose kundërshtimin) tek Këshilli i Ministrave të interkonektorëve të rinj që do të ndërtohen nga OST-ja, në bazë të legjislacionit përkatës primar ose sekondar;
- të ofrojë prova që Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka autoritetin ekskluziv për të dhënë opinione në ERE për planin e zhvillimit të rrjetit, në bazë të legjislacionit përkatës primar ose sekondar.”

Lidhur me këtë opinion vërehet se në nenin 54 të ligjit është përcaktuar se:

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij të ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

2.

3 Duke filluar nga data 1 janar 2016, i njëjti person nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë:

a) të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe të ushtrojë kontroll ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit;

b) të ushtrojë kontroll, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojë kontroll ose të ushtrojë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

c) të emërojë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojë kontroll apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

ç) të jetë anëtar i këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

4. Ndalimet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 3, të këtij neni, do të zbatohen në mënyrë të veçantë për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

5. Detyrimi i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, konsiderohet se është përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një operator i sistemit të transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

6. Kur personi i përmendur në pikën 3, të këtij neni, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person.

Për përmbushjen e detyrimit të pavarësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, nga aktivitetet e prodhimit apo furnizimit, në kuptim të nenit të lartpërmendur, janë miratuar :

- VKM-ja nr. 317 datë 27.14.2016, “Për përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike”, e cila ka përcaktuar si më poshtë:

1. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., është Ministria e Energjisë dhe Industrisë (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë).

2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST), është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë).

3. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

- Ligji nr. 8/2016, “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, në nenin 1, të te cilit është përcaktuar se:

“Ushtrimi i së drejtës së përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përfshirë edhe të drejtën e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, në shoqëritë elektroenergjetike, bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe në shoqëritë e gazit natyror bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror.”

Pra, nga përcaktimet e përmendura këtu më lartë, rezulton se secila nga ministritë e përmendura duhet të kryejë funksionin e pronarit të aksioneve në shoqëritë përkatëse. Përpara këtij ndryshimi, ishte Ministria e Financave dhe Ekonomisë ajo që ushtronte funksionin e pronarit të aksioneve (autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve) në të tria shoqëritë.

Tashmë këto rregullime në bazë të ndryshimeve në aktet e lartpërmendura janë kryer dhe, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ushtron kontroll të drejtpërdrejtë në cilësinë e pronarit për OST sh.a, ndërsa Ministria e

Infrastrukturës dhe Energjisë ushtron kontroll të drejtpërdrejtë në cilësinë e pronarit për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare sh.a dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

Por nga ana tjetër në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në nenin 31 është përcaktuar se linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

Ndërsa në nenin 60 është përcaktuar se;

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton një plan dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, në konsultim me palët e interesuara, dhe e paraqet për miratim në ERE.
8. ERE në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë.

Pra, sikurse vërehet mbetet ende pa u përmbushur kushti i parashikuar në pikën 2, paragrafi 4 i Vendimit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017, që parashikon “Bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimi, OST sh.a. do të paraqesë ERE provat dokumentare se ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i OST sh.a., Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kanë ndodhur dhe janë efektive.”

Kushti i mësipërm buron edhe nga opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë që konsideron se ushtrimi i kompetencave të mësipërme nga Ministria përgjegjëse për energjinë, çënon autonominë e OST-së, si i vetmi entitet përgjegjës për zhvillimin e një sistemi transmetimi të sigurtë dhe eficient, pjesë e të cilit janë edhe interkonektorët që janë të domosdoshëm për krijimin e rrjetit të integruar pan-europian me qëllim mundësimin e tregut të përbashkët të energjisë midis palëve të Komunitetit të Energjisë. Po kështu edhe plani i investimit 10 vjeçar i parashikuar në nenin 60 të ligjit 43/2015, është një nga funksionet themelore të OST dhe ndërhyrja e ministrisë përgjegjëse për

energjinë gjatë miratimit të tij konsiderohet gjithashtu si cënim i autonomisë së OST në ushtrimin e këtij funksioni.

Këto argumente gjejnë mbështetje në Direktivën 2009/72/KE, të Parlamentit dhe Këshillit Europian, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike”.

Për sa më sipër, këto dy parashikime duhet të ndryshohen për Operatorin e Sistemit të Transmetimit në lidhje me miratimet nga Ministria përgjegjëse për energjinë për të përmbushur detyrimin e pavarësisë së tij sipas nenit 54 dhe për këtë propozohen ndryshimet si më poshtë

Nenet e Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar) në të cilët duhet të ndërhyhet, janë neni 31 dhe neni 60, e konkretisht:

Neni 31

Ndërtimi i interkonektorëve të rinj (është)

1. Linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.
2. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e interkonektorëve të rinj, sipas parashikimeve të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të bëhet

Neni 31

Ndërtimi i interkonektorëve të rinj

1. Linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.
2. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e interkonektorëve të rinj, sipas parashikimeve të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në Nenin 60, pika 8, shfuqizohet.

ERE me Vendimet nr. 58, datë 15.03.2018, dhe nr. 47, datë 19.03.2019 ka vendosur dy herë shtyrjen e afatit në pikën 2 të vendimit nr. 43, datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.” në përputhje me nenin 54, pika

6, te Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9 pika 6 të Direktivës 2009/72/KE mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjise”, deri më datë 15.12.2019.

Vlen të theksohet se mospërmbushja e këtyre detyrimeve nga OST-ja, deri në datën 15.12.2019, referuar paragrafit 3 të Vendimit të certifikimit, sjell si pasojë rihapjen e procedurës së certifikimit në përputhje me nenin 14 të “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”, sikurse theksohet edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Heqja e certifikimit apo rihapja e procedurës së certifikimit do të sillte pasoja për OST dhe do të rrezikonte dhe pozicionin e saj si anëtare me të drejta të plota në ENTSO-E.

Gjithashtu, duke marrë shkas nga kjo iniciativë ligjore që do të ndërmerret, si dhe nisur nga praktikat e deritanishme të ndjekura për lidhjet e reja dhe nga eksperiencia e shteteve të ndryshme në rajon dhe atyre europiane, të tilla si Serbi, Itali, Francë, etj. parashikimet në legjislacionet e tyre përkatëse sygjerohet që të merret në konsideratë edhe ky ndryshim:

- Në nenin 28, pika 1, shtohet me një fjali “Asetet e lidhjes që i shtohen rrjetit ekzistues janë pronësi e Operatorit të Sistemit të Transmetimit”.
- Në nenin 28, pikat 5 dhe 7 hiqet.

Transpozimi dhe zbatimi i ndarjes funksionale dhe ligjore të Operatorit Kombëtar të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike është një detyrim për Shqipërinë nën Paketën e Tretë të Tregut të Brendshëm të Energjisë.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në kuadër të procesit të ndarjes së OSHEE sh.a, ka rekomanduar edhe përafrimin plotësisht të nenit 26, paragrafi 2, germa (c) dhe (d) të Direktivës 2009/72/EC.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në opinionin e tij, konsideron se :

- Neni 26 i Direktivës 2009/72/EC, në bashkëpunim me Vendimin e Këshillit Ministror 2011/02 / MC-EnC, detyron Palët Kontraktuese, përfshirë Shqipërinë, të transferojnë de-jure në legjislacionin kombëtar, si dhe të zbatojnë

de fakto kërkesën e funksionimit dhe të ndarja ligjore të operatorëve kombëtar të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë krijimin e një programi pajtueshmërie dhe zyrtari për pajtueshmëri.

- Më konkretisht, neni 72 i Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, transponon kërkesat e nenit 26 të Direktivës 2009/72 / EC, lidhur me ndarjen e Operatorit Kombëtar të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe përcakton një afat kohor për realizimin e këtij procesi.

- Ligji 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, megjithatë, nuk arrin të transpozojë në mënyrë korrekte kërkesat e nenit 26 paragrafi Direktivës 2009/72 / EC, nga mungesa e transpozimit të nenit 26 paragrafi 2 litera (c) dhe (d) të Direktivës 2009/72 / EC, i cili kërkon të drejtat efektive të vendimmarrjes së operatorit të sistemit të shpërndarjes të pavarur nga ndërmarrja e integruar e energjisë elektrike, emërimin e një zyrtari të pajtueshmërisë dhe miratimin e një programi pajtueshmërie.

- Përveç ndarjes legale, neni 26 i Direktivës 2009/72 / EC kërkon një numër elementësh që lidhen me pavarësinë funksionale të menaxhimit, të drejtat efektive të vendimmarrjes të njësisë ekonomike përgjegjëse për aktivitetet e shpërndarjes, krijimin e një zyrtari dhe programi pajtueshmërie, disponueshmëria e burimeve të nevojshme (përfshirë njerëzore, teknike, fizike dhe financiare) për të qenë në dispozicion të operatorit të sistemit të shpërndarjes për të përmbushur detyrat e tij, dhe një ndarje e qartë të markës dhe komunikimit të aktiviteteve të shpërndarjes nga ato të furnizimit.

Bazuar në mendimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka inicuar ndryshimin e nenit 72 të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me qëllim transpozimin e plote të parashikimeve të nenit 26 paragrafi 2 litera (c) dhe (d) të Direktivës 2009/72 / EC, dhe për këtë propozohen ndryshimet si më poshtë:

Pika 3, germa a) e nenit 72, riformulohet si më poshtë:

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ketë të drejta efektive të plota vendimarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar e energjisë elektrike, lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen ose zhvillimin e rrjetit të Shpërndarjes.

Për të përmbushur këto detyra, operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, përfshirë burimet njerëzore, teknike, fizike dhe financiare.

Shoqëria mëmë (kontrolluese), ka të drejtën e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale në lidhje me kthimin e aktiveve, miratimin e planit ekonomik financiar, ose çdo instrument ekuivalent, të operatorit të sistemit të shpërndarjes, dhe të vendosë kufijtë e përgjithshëm në nivelet e borxhit të shoqërisë bijë (të kontrolluar) .

Shoqëria mëmë (kontrolluese), nuk mund të japë udhëzime për veprimtarinë e përditshme operationale të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë dhe nuk ka të drejtë të marrë vendime lidhur me ndërtimin apo rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes, vlera e investimit të të cilave nuk tejkalon nivelet e planeve financiare të miratuara apo vlerat e përcaktuara në statutin e shoqërisë, apo legjislacionin në fuqi;

Pika 3, germa b) e nenit 72, riformulohet si më poshtë:

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të krijojë një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objekti.

Personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë (zyrtari i pajtueshmërisë së operatorit të sistemit të shpërndarjes), paraqet çdo vit në ERE, një raport vjetor, i cili përcakton masat e marra në kuadër të programit të pajtueshmërisë. Ky raport publikohet.

Zyrtari i pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka qasje në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo ndërmarrje bashkëpunuese, për të përmbushur detyrën e tij.

Ky parashikim ligjor i jep Operatorit i Sistemit të Shpërndarjes të drejta efektive të plota vendimarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar e energjisë elektrike, lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen ose zhvillimin e rrjetit të Shpërndarjes, duke krijuar pavarësi ekonomike-financiare dhe

menaxheriale te tij, dhe duke permbushur detyrimin e pavaresise te parashikuar ne Direktiven 2009/72 / EC.

Gjithshtu ky ndryshim ligjor sjell konceptin e Zyrtarit të pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, si nje organ plotësisht të pavarur dhe që ka qasje në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për të përmbushur detyrën e tij.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kërkuar mendimin e Sekretarit të Komunitetit të Energjisë për ndryshimin e Nenit 72, Pika 8, germa a) dhe b) të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe është në pritje të opinionit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është bazuar në nenet 78, pika 1 e nenit 83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Projektligji i propozuar është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektakti nuk ka përputhshmëri me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj parashikon disa shtesa dhe ndryshime në dispozitat e ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si vijon:

Neni 1 përcakton se në nenin 28 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1.Në pikën 1 shtohet një fjali me përmbajtje si më poshtë:

“Asetet e lidhjes që i shtohen rrjetit ekzistues janë pronësi e Operatorit të Sistemit të Transmetimit”.

2. Pikat 5 dhe 7 shfuqizohen.

Neni 2 përcakton se pika 1 e nenit 31, riformulohet si më poshtë:

“1. Linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që ushtron të drejtat e pronësisë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit. Linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

Neni 3, përcakton se në pikën 2, të nenit 49, në fund të shkronjës “h”, shtohet shkronja “i”, me përmbajtje si më poshtë:

“i. zhvillimin e procesit konkurrues për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë nga hidrocentralet”.

Neni 4 përcakton se, pika 8 e nenit 60, riformulohet si më poshtë:

“ERE në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri që ushtron të drejtat e pronësisë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit.”

Neni 5 përcakton se në nenin 72 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1.Pika 3, germa a) riformulohet si më poshtë:

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ketë të drejta efektive të plota vendimarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar e energjisë elektrike, lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen ose zhvillimin e rrjetit të Shpërndarjes.

Për të përmbushur këto detyra, operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, përfshirë burimet njerëzore, teknike, fizike dhe financiare.

Shoqëria mëmë (kontrolluese), ka të drejtën e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale në lidhje me kthimin e aktiveve, miratimin e planit ekonomik financiar, ose çdo instrument ekuivalent, të operatorit të sistemit të shpërndarjes, dhe të vendosë kufijtë e përgjithshëm në nivelet e borxhit të shoqërisë bijë (të kontrolluar) .

Shoqëria mëmë (kontrolluese), nuk mund të japë udhëzime për veprimtarinë e përditshme operacionale të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë dhe nuk ka të drejtë të marrë vendime lidhur me ndërtimin apo rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes, vlera e investimit të cilave nuk tejkalon nivelet e planeve financiare të miratuara apo vlerat e përcaktuara në statutin e shoqërisë, apo legjislacionin në fuqi;

2.Pika 3, germa b) riformulohet si më poshtë:

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të krijojë një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objekti.

Personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë (zyrtari i pajtueshmërisë së operatorit të sistemit të shpërndarjes), paraqet çdo vit në ERE, një raport vjetor, i cili përcakton masat e marra në kuadër të programit të pajtueshmërisë. Ky raport publikohet.

Zyrtari i pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka qasje në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo ndërmarrje bashkëpunuese, për të përmbushur detyrën e tij.

Neni 6, përcakton se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për marrjen e masave për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga strukturat teknike në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projektligji do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare të drejtpërdrejta.

MINISTRI

Belinda Balluku